

LLAZAR SIILOI

BIBLIOTEKA

· BSH-1

S 57



MIKU

TIRANË, 1963

PARATHANJE

Më kujtohet vetëm viti: 1950. Muajin nuk e mbaj mend. Atë kohë ndodheshim në Moskë për studime të larta. Në dhomën tonë të konviktit ishin mbledhur disa shokë shqiptarë. Midis tyre kishim një edhe poetin Llazari Siliqi, student të institutit të letërsisë «M. Gorki». Unë, si më i ri në mes të atyre që ishin të pranishëm, kisha qëndruar i heshtur në një cep të dhomës dhe po dëgjoja bisedat e shokëve më të rritur. Vonë, kur biseda filloi të mehej, Llazari, pak si i kuqur në fytyrë, na pyeti:

— A dëshëroni t'ju lexoj një poemë të re që kam shkruar?

Shokët e pritën me qejf këtë propozim. Dhe menjëherë miku im i ri dhe shumë i dashur i gjithë viteve të mëpastajme që nga ajo natë, nisi të na lexojë me zjarr poemën «MIKU», të cilën të gjithë e pritën me entuziazëm.

Kaluan ditë, muaj e vite. Unë ndenja edhe herë të tjera me orë të tëra me poetin

Llazar Siliqi. Me sy të skuqur nga gjumi e me laps në dorë, të ulur pranë tryezës studenteske rrinim bashkë e ai lexonte e rilexonte vargjet e mij të parë, korigjonte e më fliste me kurajo për të mbajtur fort në duar pendën.


...Kështu e kam njohur unë poetin Llazar Siliqi.

Ndoshta se pse njohja e ime me Llazar Siliqin përkoj atëhere me leximin e parë të poemës «Miku» në një rreth shoqëror, unë më dëshirë të veçantë pranova kërkesën e redaksisë së letërsisë për fëmijë të Ndërmarrjes së Botimeve «Naim Frashëri» që të shkruaj këtë dy radhë, si parathënje për këtë botim të ri të poemës, pregatitur nga autori posaçërisht për lexuesit e vegjël pionierë.

Poema «Miku» padyshim është një nga veprat më të mira poetike të autorit. Poeti është frymëzuar për këtë vepër nga një ngjarje e ndodhur pak a shumë, ashtu siç përshkruhet edhe në poemë. Në marsin e vitit 1949 në shtypin tonë u botua letra që shoku Enver Hoxha i drejtonte rreshterit Safet Malaj, i cili pasi u kthye nga ushtria u tremb shumë nga vështirësitë, me të cilat jetonte fshati i ynë në atë kohë. Në këtë letër të shokut Enver, udhëheqësit të dashur të partisë dhe popullit tonë, duket qartë se sa mirë i njihje partia hallet dhe dertët

e popullit dhe sa shumë përpiquej e luftonte ajo, si gjithnjë, për përmirësimin e jetës së popullit dhe ndërtimin e socializmit. I frymëzuar nga kjo ngjarje, poeti Llazar Siliqi na përshkruan një tablo shumë emocionante të takimit të udhëheqësit tonë me fshatarin plak Hasan Fani në kasollen e tij. Nga kjo del qartë, se edhe ideja kryesore e poemës janë lidhjet e ngushta të partisë me popullin. Poema fund e krye përshkohet nga optimizmi i madh i autorit për jetën e lumtur që e pret popullin tonë dhe për realizimet e mëdha të socializmit, shumë nga të cilat ju i shihni në jetë në kooperativat e shumta që janë krijuar anembanë Shqipërisë. Poema është ndërtuar në detaje realiste, të cilat të ndihmojnë të njohësh rrugën e vështirësive nga kaloi populli ynë gjatë gjithë viteve të pasçlirimit.

BEDRI DEDJA





Pranë oxhakut rri Hasani,
pi duhan edhe mendon.
Bumbullon e fryn murlani,
tymi sytë krejt t'i verbon . . .

Hej ti, tym, o tym i zi,
shumë ke ndejë n'kësollat tona!
Por ka ardhë një mot i ri
e nuk duem në tym të zi
ta çojmë jetën. Porse dona
t'rrojmë si njerz, t'na çelen sytë,

t'kemi bukë e t'kemi dritë,
t'kalojmë ditët pa u mërzitë,
t'kalojmë vitet kurrë pa u plakë!

N'votër drutë ç'po ndizen flakë.
Së ç'ia ngrohin zemrën plakut,
që mendon sot pranë oxhakat
si i kaluen të njëqindvjetat,
se si i shkoi si andërr jeta . . .

Por ja dera po troket:

— A don miq, o Hasan Fani?

— Hajde, bujrum! —

thurret Hasani.

Edhe çohet, miqtë i pret,
mbrendë u prin si e lyp zakoni
edhe nuses i ban za
me pjekë kafet.

— Urdhënoni!

Bukë e krypë e zemër ka
për miq t'vet gjithmonë shqiptari,
po për miq t'mirën q'ia duen. —

Rreth oxhakat si u rreshtuen,
ndër tre miqtë fjalën i pari
merr një burrë, një burrë azgan:
— Kemi ardhë na, o Hasan,
për me pa ndër këto ana
si rrojnë njerzit. Nga Tirana
jemi nisë me ndejë me ju,

me u kshillue, me bisedue,
si ma mirë na me punue,
si Shqipninë na me e ndërtue,
që t'ketë bukë e begati,
ta bajmë jetën si n'Rusi, —
gjithë anmiqtë t'na e kenë zili! —

Edhe ndizet muhabeti.
N'votër zjarri buzëqesh.
Plaku thotë veti me veti:
miq të tillë asht mirë të kesh!
Edhe zemrën fjala e mikut
thue ia ngroh e thue ia ndrin,
njëqindvjetat Hasan Fani
thue mbi shpinë nuk po i ndin . . .

Thith duhan e tue mendue
fillon miqve me u tregue:

— Dy vjet luftova nëpër pyje,
dy vjet, o biri im,
atje në buzë të një korije
varrosa nipin tim.
Ma vranë ballistat, i vraftë zoti!
Shtëpinë por e kam plot
me bij e nipa, dhe ksi moti
hambar' do e kemi plot!



Në hasmëni më shkoi gjithë jeta
me agà e me bejlerë,
porse i vetëm unë nuk mbeta
e dola unë me nder.

Sepse na priu, o bir, Partija,
na qiti faqebardhë,
dhe ka besim fshatarësija —
dit t'bukra kanë me ardhë!


Por, ndoshta, s'do i gëzoj, o bir . . .

Të rrojnë fëmijët tonë!

(Megjithse vdekja do t'ish mirë
me m'ardhë paksa ma vonë! . . .)

Dy nipa, Aliun dhe Selimin,
i kam unë në ushtri,
me synin katër ruejnë kufinin
në jugë e në veri.
Kam shpresë këtë vit dhe Selim trimi
m'pranohet në Parti! —


Shikojnë miqtë si pranë oxhakut
flet Hasani, sytë shkëndi,
si për t'ardhmen andrron plaku,
porse plak me shpirt të ri.
Duert i ka t'zeza si toka,
krejt reckosë rrobet e tija,
porse zemrën plot barot ka, —
gjak të ri i dha Partija!



Kalojnë orët. Muhabeti
rreth oxhakut po vazhdon.
Jashtë natyra asht e qetë,
dielli fshatin tash ndriçon...
Edhe miku gojëmjaltë
me Hasanin kuvendon.
Pyet për tokë, që i dha Partija,
për tokë t're që paska hapë
plaku vetë me tre të bijtë,
pyet a u vijnë hakut kulakve,
që duen fshatit me i pi gjak'n e
duen me mbjellë veç mosbesim.
Pyet për hallet që ka shpija.
A po e lodh ndopak pleqnija?
Po a shkojnë në shkollë fëmijtë?
Gratë mësojnë këndim e shkrim?..—
Thue fshatar asht lé e rritë!

Fjal't e mikut të panjohun
zembrën plakut ç'po ia ngrohin.
Dhe Hasani, pa e kuptue,
ndjen nevojën me tregue
n'jetë ç'ka heqë e ç'ka provue,
ndjen nevojën me u kshillue,
sepse miku, po, i ri,
por shok s'paska në urti,
zembrën paska plot dashni
për atdhe e për njerzi!

Rri Hasani edhe dëgjon
 miku i shtrenjtë ç'asht kah tregon,
 thith duhanin, sytë i mbyll,
 edhe, ja, sikur shikon . . .



Sheh Hasani fusha t'gjana
 e grunore porsi ar, —
 gaz i madh për katundarë!
 Me maqina pun't e randa
 ata i bajnë, si vlezën rrojnë,
 bashkë punojnë e bashkë gëzojnë,
 si asht ma mirë jetën e çojnë!
 Katundarë e punëtorë
 shkojnë të lidhun dorë-për-dorë,
 lidhun, po, si mish e thue!
 Po ç'janë sytë tue më shikue? . .

Ja: shkretinat, — o çudi! —
atje i kthehan në kopshtije



me burime edhe me hije,
n'ara plot me begati! . .

Vazhdon miku me tregue.
Edhe plaku te oxhaku

herë lviz kokën tue pohue,

herë hap gojën krejt mahnitë,

nsa një lot në sy i shëndrit . . .

— Eh, shumë heret n'botë ke ié.

pak gëzim ke pa mbi dhé,

pak gëzim n'këtë jetë ke pa!

Eh, Hasan, o Hasan Fani,
t'kishe lé ma vonë paksa! .. —
flet me vehte xha Hasani.
Ma n'fund koha erdh me u çue
Miqtë filluen me radhë me u falë.
At'herë plaku :

— Nja dy fjalë
due m'ju thanë, o bijtë e mij,
se në zemër m'keni hy,
një amanet m'ju lanë unë due :
Në Tiranë ju kur të shkoni,
t'fala Enverit të m'i çoni
edhe vetë me gojë t'i thoni --
«Hasan Fani shndet t'dërgon,
prej së largu t'përqafon,
jetë të gjatë, gëzim, t'i thoni,
Hasan Fani të uron! ..» —

Buzën n'gaz tre miqtë e vunë
edhe plakut iu drejtuen :
— S'asht nevoja, o Hasan,
s'kem pse shkojmë na në Tiranë!
Vetë Enveri asht këtu,
ti me te ke bisedue,
mundesh vetë me e përqafue,
mundesh t'fala vetë me i dhanë! .. -


Se ç'ka ngri plaku në kambë.
Fërkon sytë edhe s'beson,
zemra vrullshëm i troket,
nga mallngjimi memzi flet,
kah Enveri duert drejton
e me mall e përqafon:

— Rrofsh sa malet, rrofsh, o bir!
Rroftë Partija që ke rritë,
që na e bani Shqipninë t'libër,
që na lidhi me miq t'mirë,
që na dha tokë edhe dritë,
që na i çeli, o bir, sytë,
që na e ktheu prap të ritë! —

Në oborr t'kësollës plaku
ka dalë miqt me i përcjellë.
Me fmi n'gji qëndron te praku
nusja e nipit. Shkojnë tue u hjedhë
në oborr tre camërdhokë,
tue vrapue, tue u shtri përtokë,
lozin, qeshin shok me shok.
Plaku ynë stërnipat thurret.
Kambëzbathë të tre vrapojnë
edhe Enverin e rrethojnë...

Kanga n'fshat diku buçet.
Dielli ftyrat po ndriçon...
Prisi larg ku vallë shikon,
ndërsa flok't fëmijve u lmon?..

Ndoshta Enveri për një ças
t'ardhmen vetë do jetë tue pa ...
Nëpër arat rreth-e-rritull,
plot traktorë tokën tue ça,
n'shkolla tue mësue fëmijtë,
elektrikë n'dhoma tue shndritë,
camërdhokët, ndoshta, t'rritun,
agronomë e inxhinierë
asht tue i pa shoku Enver ...



Pranë oxhakut rri Hasani,
pi duhan edhe mendon . . .
Zemra plakut ç'i këndon!
N'zemër t'tij ka çelë pranverë!
N'zembrën time kndo, pranverë!
Lulëzo kudo, pranverë!
Lulëzo nëpër Shqipni!
N'socializm na prij, Parti!

Redaktor: Mojsi Zaloshnja
Korektore letrare: Neka Turkeshi
Piktor: Bujar Zajmi
Redaktor teknik: Adem Lita

Tirazhi: 6000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-55

Shtyp. N.I.Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURJ» — Tiranë

JANË NË QARKULLIM

LETËRSI ARTISTIKE PËR FËMIJË. Autorë të huaj

	Lekë
V. SAPARIN -- Tymi i kristaltë	10
L. CAROL -- Liza në botën e çudirave	20
Autorë të ndryshëm -- Ruajtësi i patave	10
I. VOLK -- Tregime për majmunët	20
H. MALO -- Pa familje (vëll. I, II)	45
A. DOROHOV -- Xhuxhët dhe gjigandët	20
Autorë të ndryshëm -- Dua të di gjithëka	30
M. FEJETOV -- Vajza nga Stalingradi	10
E. GLENVIL -- Gojama krifëverdhe	25
Autorë të ndryshëm -- Zogu i kuq	40
A. GAJDAR -- Bumbarashi	15
A. VENDESKI -- Kur të bëhem i madh	10
V. G. KOROLENKO -- Fëmijët e nëntokës	15
GJ. NESTOR -- Mbreti i uridhëve rrëzohet nga fronti	20
ÇUNG TIEN-JI -- Lin madhi dhe Lin vogli	20